

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – Departamenti për krime të rënda - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetari i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Driton Muharremi anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Eroll Gashi si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.B. nga fshati ... K.Deqan, për shkak të veprës penale Vrasja në tentativ nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të palës së dëmtuar M.B., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.74/18, datë 12.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më **12.dhjetor. 2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar M.B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.74/18, datë 12.10.2018 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin PKR.nr.74/18, datë 12.10.2018, të akuzuarin S.B., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vrasja në Tentativë nga Neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, për të cilën i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti, në të cilin dënim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim, prej datës 20.08.2018, e deri më 12.10.2018,

I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 50€, paushallin gjyqësorë në shumë prej 25€, si dhe 50€, për fondin e kompensimit të Viktimave në shumë prej 50€, gjithsejtë 125€, e të cilat është obliguar që ti paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari M.B. për realizimin e kërkesës pasuror- juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i palës së dëmtuar M.B., - avokati B.A., nga Peja, lidhur me vendimin mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të akuzuarit S.B. t'i shqiptoj një dënim me të latë me burgim e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën me shkrim PPA/L.nr.507/2018, datë 09.11.2018, ka propozuar që ankesa e e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i lartë me burgim për veprën penale të kryer.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, në të cilën prezantuan përfaqësuesi i palës së dëmtuar M.B.-Av B.A. nga Peja ndërsa munguan i dëmtuari M.B., i akuzuari S.B. për të cilin egziston konstatimi se gjendet jashtë shtetit, mbrojtësi i të akuzuarit Av-A.K. si dhe Prokurori i Apelit edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullte, andaj seanca e kolegjit u mbajti në pajtim me nenin 390 par.4 të KPRK-së. Përfaqësuesi i palës së dëmtuar-Av B.A. mbeti në tërësi pran ankesës së ushtruar me shkrim duke propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar:

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin aktgjykim sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se i njëjti aktgjykim nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Gjendja faktike nuk ka qene objekt shqyrtimi ngase i akuzuari e ka pranuar fajësinë e i cili pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lendes dhe është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ku i njëjti pranim ka mbështetje në faktet që i përmban aktakuza.

Ndërsa, sipas pretendimit ankimor të përfaqësuesit të palës së dëmtuar M.B.-Av.B.A. që ka të bëjë me vendimin lidhur me sanksionin penale – *neni 383 par.1 nën par 1.4 të KPPK-së* kjo gjykatë e vlerëson si të pabazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ka marr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të dispozitave të nenit 73 ,74,75 dhe 76 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e ku si rrethane veqanerisht lehtësuese ka marr pranimin e fajësise, kërkim faljen publike ndaj te

dëmtuarit ndërsa si rrethane renduese ka marr shkallen e larte te rrezikshmërisë shoqerore te veprës penale te kryer dhe përgjegjesisë penale te kryesit. Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimet ankimore te përfaqësuesit te palës se dëmtuar per shqiptimin e nje dënimi me te larte me burgim dhe gjeti se te njejtat nuk janë te bazuara ngase nga aktgjykimi i Gjykates Themelore ne Peje-Dega ne Deqan,P.nr.234/17 te dt.21.05.2018 ne te cilën thirret përfaqësuesi i palës se dëmtuar shihet se edhe i dëmtuari M.B. ne ate aktgjykim eshte dënuar per shkak te veprës penale te sulmit nga nenin 187 par.1 te KPRK te kryer ndaj tani te akuzuarit S.B. ndërsa i akuzuari S.B. eshte dënuar per shkak te veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2 te KPRK.

Per kete arsye Gjykata e Apelit gjeti se dënimi i shqiptuar ndaj te akuzuarit S.B. nga ana e Gjykates se shkalles se pare dhe aplikimin e neneve 73,74,75 dhe 76 te KPRK-se eshte i drejte dhe i ligjshëm dhe ne përpjesëtim me peshën e veprës penale te kryer dhe përgjegjësinë penale te kryesit dhe se me nje dënim te tille do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 41 te KPRK.

Nga të cekurat më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr. 534/18 dt.12.dhjetor. 2018

Procesmbajtesi

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit

Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi

Driton Muharremi
